

SEKSI PA MIRATIM ËSHTË PËRDHUNIM!!

Çfarë është dhuna seksuale?

Dhuna seksuale është çfarëdo akti seksual i kryer pa miratimin e partnerit/es, ose çdo përpjekje për të kryer një veprim të natyrës seksuale me një person tjetër pa miratim të dhënë lirisht. Dhuna seksuale mbetet e tillë pavarësisht marrëdhënieve mes dhunuesit dhe viktimës, në çdo rrethanë dhe ambient, përfshirë shtëpinë dhe punën. Këtu përfshihen sulmi seksual, përdhunimet, përdhunimi në marrëdhënie martesore, ngacmimi seksual, përndjekja dhe shpërndarja e fotografive apo regjistrimeve me natyrë seksuale, si dhe forma të tjera që shpesh kalojnë pa u vënë re.

Dhunë seksuale është kur dikush shkel kufinj të tu seksualë pa lejen tënde! Dhuna seksuale lidhet ngushtë me kontrollin dhe ushtrimin e pushtetit të një personi mbi një tjetër.

Çfarë është miratimi?

Miratim është dakortësia me vullnet të plotë dhe e vazhdueshme për t'u përfshirë në një aktivitet seksual specifik. Miratimi nuk mund të merret me detyrim apo me presion. Miratimi mund të anulohet - çdokush ka të drejtë të ndryshojë mendje në çdo moment, rreth asaj që ndjen se do të bëjë! Miratimi është gjithnjë i nevojshëm për aktivitetet seksuale, edhe nëse je i/e martuar, në një marrëdhënie të vazhdueshme apo të rastësishme seksuale.

Mosha e miratimit seksual në Evropë është kryesisht 14 deri në 15 vjeç. Në Shqipëri mosha e parashikuar me ligj është 14 vjeç. Përfshirja në aktivitete seksuale me fëmijë nën këtë moshë nuk konsiderohet e pranuar nga të dy palët dhe është e dënueshme ligjërisht.

Pse është i rëndësishëm miratimi?

Dhuna seksuale mund të ketë pasoja të rënda psikologjike dhe emocionale, por fatkeqësisht raportohet shumë pak.

Seksi duhet të jetë një eksperiencë pozitive dhe gjithnjë duhet të ndodhë me miratimin tënd të plotë. Ti ke të drejtë të vendosësh për trupin dhe preferencat e tua seksuale!

Nëse ndaj teje apo dikujt që ti njuh është ushtruar dhunë seksuale dhe ke nevojë të këshillohesh me dikë, mos hezito të kërkossh ndihmë!

Telefono në numrin e Linjës Kombëtare Falas 116 117! Shërbimi ofrohet për 24 orë, 7 ditë të javës!

Këshillueset tona do të të dëgjojnë dhe do të të udhëzojnë se çfarë të bësh më tej, ku të drejtohesh për të kërkuar mbështetje në zonën ku ti jeton, çfarë ndihme dhe mbrojtje mund të të ofrohet nga institucionet publike dhe organizatat e grave!



Na kontaktoni:

AWEN – Rrjeti i Fuqizimit të Gruas në Shqipëri

Adresa: Rr. 'Vaso Pasha', P.16, Shk. 14, Tiranë

Website: www.awenetwork.org

E-mail: info@awenetwork.org

Na ndiqni në Facebook: AWEN - Albanian Women Empowerment Network



Ky material është financuar nga Agjensia Ndërkombëtare Suedeze për Zhvillim dhe Bashkëpunim - Sida. Sida nuk është domosdoshmërisht dakort me opinionin e shprehur në këtë fletëpalosje.